

VENDIM
Nr. 729, datë 12.12.2018

**PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONET, FUNKSIONIMIN, FUSHËN E VEPRIMTARISË,
KRITERET E ANËTARËSIMIT DHE MODALITETET E PUNËS SË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka si objekt institucionalizimin e Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional, si një organ këshillimor trepalësh, i cili, nëpërmjet veprimtarisë, kontribuon në reformimin e sistemit të arsimit dhe formimit profesional (në vijim, AFP) dhe rritjen e bashkëpunimit me biznesin për fuqizimin e tij.

2. Këshilli Kombëtar i AFP-së kryesohet nga ministri përgjegjës për AFP-në dhe përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, përfaqësues të sektorit publik e privat, si më poshtë vijon:

- a) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin, në nivel zëvendësministri;
- b) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për AFP-në, në nivel zëvendësministri;
- c) Një përfaqësues i shoqatës së njësive të qeverisjes vendore me numrin më të madh të njësive;
- ç) Dy përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve me numrin më të madh të anëtarëve;
- d) Dy përfaqësues nga organizatat e punëmarrësve me numrin më të madh të anëtarëve;
- dh) Një përfaqësues nga institucionet jopublike ofruese të AFP-së me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve.

3. Këshilli funksionon sipas modaliteteve të mëposhtme:

- a) Këshilli mbledhet mbi bazën e një kalendarit, por jo më pak se një herë në tre muaj;
- b) Kryetari i këshillit vendos për datën dhe kohën e mbledhjes së radhës, përveç rasteve kur vetë këshilli ka vendosur ndryshe;
- c) Çdo ndryshim në datën dhe në kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar, në mënyrë që të njihet me këto ndryshime;
- ç) Mbledhjet bëhen nëse në to është e pranishme të paktën gjysma e anëtarëve të këshillit;
- d) Funksionimi i këshillit mbështetet nga sekretariati teknik, i cili përbëhet nga dy punonjës të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK);
- dh) Sekretariati teknik bashkërendon veprimtarinë e këshillit dhe kryen këto detyra:
 - organizon mbledhjet e këshillit dhe krijon kushtet e nevojshme për zhvillimin e tyre;
 - përpunon informacionet e propozuara në mbledhjen e këshillit në formën e kërkuar për ekzekutim;
 - komunikon me kryetarin dhe me anëtarët e këshillit lidhur me rendin e ditës/datën, orën dhe vendin e mbledhjes së këshillit;
 - shpërndan dokumentacionin e mbledhjes dhe informacione të tjera të anëtarët e këshillit;
 - mban procesverbalin e mbledhjeve të këshillit;
 - arkivon dokumentacionin e mbledhjeve të këshillit;
 - lehtëson funksionimin e grupeve të përkohshme të ngritura nga këshilli.

4. Në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional hapet një faqe e veçantë për veprimtarinë e këshillit, për të cilin veprohet, si më poshtë vijon:

- a) Sekretariati teknik i KAFPK-së merr masat për hapjen e një lidhjeje të veçantë në faqen zyrtare në internet të ministrisë për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të AFP-së;

b) Ky sekretariat përgatit dhe publikon, në mënyrë korrekte dhe të shpejtë, të gjitha informacionet që mund të bëhen publike;

c) Para publikimit merret miratimi i kryetarit të këshillit.

5. Fusha e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të AFP-së është, si më poshtë vijon:

a) Zhvillimi i dialogut social për zhvillimin e sistemit të AFP-së në nivel qendror, rajonal dhe lokal;

b) Rekomandime për një koordinim sa më të mirë të veprimtarive të AFP-së;

c) Rekomandime për politika dhe strategji të zhvillimit të AFP-së në Shqipëri;

ç) Nxitja e mekanizmave të zhvillimit dhe të vlerësimit të sistemit të AFP-së;

d) Rekomandime për përmirësimin e kurrikulës, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe komunitetit të biznesit;

dh) Propozime për hartimin/përpunimin e listës së profesioneve dhe të standardeve të aftësive profesionale;

e) Propozime për përmirësimin (ose ndryshimin) e sistemit të financimit të AFP-së;

ë) Propozime për projekte të reja në sistemin e AFP-së;

f) Propozime për ngritjen e strukturave në mbështetje të sistemit të AFP-së;

g) Propozimi i raportit vjetor kombëtar të AFP-së, dhe paraqitja e tij në Këshillin e Ministrave;

gj) Rekomandime për administrimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në sistemin e AFP-së.

6. Kriteret e anëtarësimit në Këshillin Kombëtar të AFP-së janë, si më poshtë vijon:

a) Përfaqësuesit e këshillit, sipas shkronjave “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 2, të këtij vendimi, të jenë drejtues të nivelit të lartë të organizatave/institucioneve që përfaqësojnë;

b) Përfaqësuesit e këshillit, sipas shkronjave “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 2, të këtij vendimi, të kenë njohuri dhe eksperiencë në fushën e AFP-së;

c) Kryesuesi i këshillit u drejtohet zyrtarisht institucioneve/organizatave që janë të përfaqësuara në përbërje të këshillit për caktimin e përfaqësuesve të tyre;

ç) Anëtarët e një institucioni të përfaqësuar në këshill e fitojnë këtë cilësi me aktin e emërimit të tyre si anëtarë nga kryesuesi i këshillit, pas propozimit të tyre nga ana e institucionit që përfaqësojnë;

d) Anëtarët e këshillit, sipas shkronjave “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 2, të këtij vendimi, që nuk marrin pjesë pa shkaqe të arsyeshme në dy mbledhje radhazi të këshillit, lirohen me urdher të kryesuesit. Në një rast të tillë kryesuesi i kërkon drejtuesit të institucionit të përfaqësuar në këshill propozimin e një zëvendësuesi të këtij anëtari brenda një afati prej 30 ditësh.

dh) Mandati i anëtarit të këshillit, në cilësinë e përfaqësuesve, zgjat 3 vjet me të drejtë riemërimi.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet/organizatat përfaqësuese në Këshillin Kombëtar të AFP-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama